

**UDHËZIM**  
**Nr. 11 datë 28.5 2025**

**PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT FINANCIAR TË VLERËS SË PLOTË TË  
PROJEKTIT, NË PËRPUTHJE ME SPECIFIKAT E SEKTORIT, MBI BAZËN E TË  
CILIT PËRCAKTOHET MËNYRA DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT TË  
PROJEKTIT TË INVESTIMIT PUBLIK**

Në përputhje me nenin 25, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pikën 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 27.12.2022, “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”, i ndryshuar, ministri i Financave

**UDHËZON:**

1. Çdo propozim për projekt investimesh publike, që ka një vlerë të plotë mbi kufirin e përcaktuar sipas lidhjes nr. 1, për t’u përfshirë në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, duhet t’i nënshtrohet një procesi të plotë vlerësimi përpara fillimit të procesit buxhetor.

2. Çdo propozim për projekt investimesh publike që ka një vlerë të plotë brenda kufijve financiarë të përcaktuara sipas lidhjes nr. 2, përpara fillimit të procesit buxhetor duhet të përgatisë studimin e fizibilitetit të thjeshtuar.

3. Udhëzimi nr. 5, datë 5.4.2024, “Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit, mbi bazën e të cilit përcaktohet mënyra dhe procedura e vlerësimit të projektit të investimit publik”, shfuqizohet.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I FINANCAVE**  
**Petrit Malaj**

**Lidhja Nr.1: Kufijtë financiarë të projekteve që përfshihen në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare**

SEKTORI	NËNSEKTORI	VLERA
Digjital	Ndërlidhja me Bazë të Gjerë	Mbi 1,500,000,000 Lekë
	Infrastruktura e-GOV	
	Sisteme informacioni	
	Platformat e Inovacionit	
Zhvillimi Ekonomik	Agrikultura	Mbi 1,500,000,000 Lekë
	Zhvillimi i Biznesit	
	Infrastruktura Bregdetare dhe Detare	
	Sipërmarrja	
	Industria	
	Zhvillimi Rajonal	
	Turizmi	
Energjia	Eficienta e Energjisë	Mbi 1,500,000,000 Lekë
	Prodhimi I Energjisë	
	Transmetimi I Energjisë	
	Gazi	
	Nafta	
	Energjia e Rinovueshme	
Mjedisi	Menaxhimi I Fatkeqësive	Mbi 1,500,000,000 Lekë
	Mbrojtja nga Përmbytjet	
	Zhvillimi I Qëndrueshëm	
	Menaxhimi I Mbetjeve, Landfilllet	
	Furnizimi me Ujë	
Social	Kultura	Mbi 1,500,000,000 Lekë
	Edukimi dhe Sportet	
	Shëndetësia	
	Strehimi	
	Siguria e Brendshme	
	Drejtësia	
	Mbrojtja Sociale	
Transporti	Transporti Ajror	Mbi 2,500,000,000 Lekë
	Transporti në Ujërat e Brendshme, Portet	
	Transporti Hekurudhor	
	Transporti Rrugor	

Lidhja Nr. 2: Kufijtë financiarë të projekteve që përgatisin studim fizibiliteti të thjeshtuar, por nuk janë pjesë e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare

SEKTORI	NËNSEKTORI	VLERA
Digjital	Ndërlidhja me Bazë të Gjerë	Mbi 700,000,000 Lekë - 1,500,000,000 Lekë
	Infrastruktura e-GOV	
	Sisteme informacioni	
	Platformat e Inovacionit	
Zhvillimi Ekonomik	Agrikultura	Mbi 700,000,000 Lekë - 1,500,000,000 Lekë
	Zhvillimi i Biznesit	
	Infrastruktura Bregdetare dhe Detare	
	Sipërmarrja	
	Industria	
	Zhvillimi Rajonal	
	Turizmi	
Energjia	Eficienta e Energjisë	Mbi 700,000,000 Lekë - 1,200,000,000 Lekë
	Prodhimi I Energjisë	
	Transmetimi I Energjisë	
	Gazi	
	Nafta	
	Energjia e Rinovueshme	
Mjedisi	Menaxhimi I Fatkeqësive	Mbi 700,000,000 Lekë - 1,500,000,000 Lekë
	Mbrojtja nga Përmblytjet	
	Zhvillimi I Qëndrueshëm	
	Menaxhimi I Mbetjeve, Landfillet	
	Furnizimi me Ujë	
Social	Kultura	Mbi 700,000,000 Lekë - 1,500,000,000 Lekë
	Edukimi dhe Sportet	
	Shëndetësia	
	Strehimi	
	Siguria e Brendshme	
	Drejtësia	
	Mbrojtja Sociale	
Transporti	Transporti Ajror	Mbi 2,00,000,000 Lekë - 2,500,000,000 Lekë
	Transporti në Ujërat e Brendshme, Portet	
	Transporti Hekurudhor	
	Transporti Rrugor	